

Federata e Futbollit e Kosovës (tutje referuar si “FFK”) konform nenit 68, të Ligjit nr. 2003/24 për Sportin (tutje referuar si “Ligji për Sportin”), si dhe konform nenit 41, paragrafi 1, pika a), të Statutit të Federatës së Futbollit të Kosovës të vitit 2023, nepërmjet Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, me datë 11.07.2023 shpall publikisht këtë:

## **FTESË PËR OFERTË**

### **Për të drejtat ekskluzive për transmetim të ndeshjeve sportive ne futboll (FFK)**

**Hyrje:** FFK është organi më i lartë udhëheqës i futbollit në Kosovë dhe e njëjta konform nenit 68, të Ligjit për Sportin, është pronare e të gjitha të drejtave televizive për të gjitha ndeshjet e futbollit të zhvillohen në ligat lokale dhe në superligë në Kosovë. FFK duke ëënë pronare e të gjitha të drejtave televizive për të gjitha ndeshjet e futbollit të organizohen në Kosovë në të gjitha ligat lokale dhe në superligë, është e interesuar që këto të drejta t’ia shes subjektit që bën ofertën më të pranueshme për FFK-në. FFK synon që përmes shitjes së këtyre të drejtave, qytetarin e Kosovës ta vendosë sa më afër futbollit vendor.

#### **1. Kontraktuesi:**

Palë kontraktuese e ofertuesit të suksesshëm do të jetë Federata e Futbollit të Kosovës, me adresë në rrugën “28 Nëntori” numër 171, 10 000 Prishtinë.

#### **2. Lënda e Kontratës:**

Lëndë e kontratës do të jenë të drejtat televizive të transmetimit direkt të ndeshjeve të Superligës së Kosovës në futboll.

#### **3. Kohëzgjatja e Kontratës:**

Kohëzgjatja e kontratës të lidhur me ofertuesin e suksesshëm do të jetë nga për sezonën futbollistike 2023/2024 deri të përfundon kampionati i viti 2024 (verë 2024) me mundësi vazhdimi edhe për një vit.

#### **4. Vendi i përmbushjes:**

Vendi i përmbushjes do të jenë stadiumet e anëtarëve të Superligës së Kosovës në futboll dhe vendet tjera të përcaktuar nga FFK-ja.

## **5. Mënyra e përzgjedhjes së ofertuesit:**

FFK do të ftojë dhe të këshillohet me ofertuesit e zgjedhur të cilët i kanë përmbushur kërkesat për përshtatshmëri, kërkesat mbi gjenjen ekonomike dhe financiare, kërkesat për përshtatshmëri profesionale, dhe kërkesat mbi mundësitë teknike si janë të përcaktuara me këtë ftesë dhe zgjedhjen e tyre do ta bëjë me anë të negociatave dhe këshillimeve. Pas këshillimit dhe negociatave, FFK do të përzgjedh ofertuesin me të cilin do të nënshkruaj Kontratën.

## **6. Subjektet e përshtatshëm për ofertim:**

- 6.1. Ofertë në bazë të kësaj ftesë mund të paraqesin vetëm subjektet të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet e caktuara në këtë ftesë për ofertë.
- 6.2. Të gjitha ofertat e parashtruara nga subjektet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e cekura në këtë ftesë nuk do të shqyrtohen nga FFK.

## **7. Afati dhe forma e dorëzimit të ofertës:**

- 7.1. Afati për paraqitjen e ofertës është 7 (shtatë) ditë, dhe i njëjti fillon të rrjedhë nga publikimi i kësaj ftesë në përkatësisht nga data 11.07.23 deri më datë 18.07.23
- 7.2. Të gjitha ofertat e dorëzuara pas datës 18.07.2023\_ nuk do të shqyrtohen nga FFK.
- 7.3. Oferta mund të dorëzohet në njërin nga format si në vijim:
  - ❖ fizikisht në FFK në rrugën “ 28 Nëntori”, numër 171, 10 000 Prishtinë, të cilat protokolohehen nga stafi i FFK-së;
- 7.4. Të gjitha ofertat e dorëzuara duhet të jenë të nënshkruara nga personat kompetent dhe të vulosura nga me vulë të biznesit.
- 7.5. Ofertat e dorëzuara në ndonjë formë tjetër nga ato të cekura si më lartë nuk do të shqyrtohen nga FFK.
- 7.6. Ofertat të cilat nuk janë të nënshkruara dhe plotësuara nuk do të shqyrtohen nga FFK.

## **8. Kërkesat për përshtatshmëri të ofertës:**

**8.1. Oferta e ofertuesit, nuk do të konsiderohet e përshtatshme, nëse ofertuesi, ndonjë punëtor, menaxher ose drejtor i tij, apo ndonjë subjekt i ndërlidhur më të:**

- a. Ka lenë pjesëmarrës në përgatitjen e ftesës për të bërë ofertë, apo ndonjë dokumenti tjetër i cili është pjesë e ftesës për të bërë ofertë;
- b. Në të gjitha rastet kur paraqitet konflikt interesi;

**9. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe finaciare:**

- a. Ofertues duhet që 3 (tre) vitet e fundit të ketë qarkullim bankar mbi 2 milion euro) euro dhe këtë ta provojë përmes gjendjes së llogarisë bankare.

**10. Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:**

- a. Ofertuesi duhet të jetë i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave *(Ofertuesi duhet të dorëzojë certifikatën e licencimit)*

**11. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale:**

- a. Ofertuesi duhet të garanton tranmetimin e sinjalit televiziv direkt me kohë reale me zhvillimin e ndeshjes
- b. Ofertuesi duhet të bëjë realizimin e ndeshjeve minimum me 7 kamera, sipas planit të kamerës (gjeni të bashkangjitur) dhe keëkresave të FFK-së
- c. Ekipi realizues duhet të ketë eksperiencë të realizimit të ndeshjeve futbollistike me teknologjine VAR
- d. Ofertuesi duhet që tranmetimin ta bëjë në formatin 1080 i 50
- e. Ofertuesi duhet të punoj grafikate televizive konform kërkesës së FFK-së rreth informatave të ndeshjes dhe VAR.
- f. Ofertuesi duhet të ketë në dispozicionin minimum 3 OBV-an deri në 5. për përcjellen e ngjarjeve sportive në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**12. Të tjera:**

Ofertuesit nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim nga FFK për përgatitjen e materialit ofertes apo për negociatat eventuale. FFK rezervon të drejtën që ti negocioj kushtet e kontratës.